



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:171731

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05728425

**Ac.nr.446/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci – kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli Prishtinë, kundër të paditurit A.Z., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra juridike “K.”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson I.R., rruga “...”, me objekt kontesti për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 4,647.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.449/13, të datës 10.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurit A.Z., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.449/13, i datës 10.08.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.449/13, të datës 10.08.2020, ka vendosur si në vijim: “**APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve ( BKS), me seli në Prishtinë. **II. DETYROHET** i padituri A.Z., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve ( BKS), me seli në Prishtinë, t’ia kompensoi shumën prej 4,647.00 €, në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 16.09.2011, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar dhe atë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 195 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar në afatin ligjor ka parashtruar ankesë dhe atë për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon si të bazuar ankesën e të paditurit dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.449/13, i datës 10.08.2020, dhe të refuzon padinë si të pabazuar.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, me datë 04.10.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurit A.Z., nga fshati ..., Komuna Podujevë, për rimbursimin e dëmit të cilën paditësja ia kishte kompensuar palës së dëmtuar në aksident S.R., nga Podujeva. Po ashtu paditësja kundër të paditurit, me datë 15.04.2014, kishte paraqitur padi tjetër për rimbursimin e dëmit të cilën paditësja ia kishte kompensuar palës së dëmtuar në të njëjtin aksident M.A., nga Podujeva. Gjykata në seancën përgatitore sipas propozimit të përfaqësuesit të palës paditëse dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës ka bërë bashkimin e këtyre dy lëndëve C.nr.449/13 dhe C.nr.196/14, të cilat kanë të bëjnë me të njëjtin aksident trafik, dhe lënda u caktua që të mbaj numrin C.nr.449/13. Në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditësit ka theksuar së i padituri me datë 16.09.2011, me automjetin VW Golf, me targa të regjistrimit ..., ka shkaktuar aksident trafik në Podujevë, me ç' rast automjeti me të cilin paditësi i ka shkaktuar aksident trafik nuk ka qenë i siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit. Ka theksuar se bazuar në Ligjin nr.04/L-018 për sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, paditësja ka qenë e obliguar që të dëmtuarve t'ia kompensoj dëmin të cilët e kanë pësuar në këtë aksident, dhe të njëjtin tani kërkon që ta rimbursoj nga shkaktari i aksidentit respektivisht nga i padituri në rastin konkret. Ka theksuar së me provat e administruara është vërtetuar si baza juridike ashtu edhe lartësia e kërkesëpadsë, duke propozuar gjykatës që ta aprovon të bazuar kërkesëpadinë e paditëses për shumën e kompensuar për të dëmtuarin M.A., në vlerë 647€, si dhe shumën e kompensuar në emër të dëmtuarit S.R. si vlerë e tërësishme 4,000.00€, në shumën e përgjithshme prej 4,647.00 €, me kamat ligjore si dhe shpenzimet procedurale. I padituri në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padsë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.449/13, të datës 10.08.2020, me të cilin e ka aprovuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në bazë të provave të administruara rezulton së i padituri A.Z., ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin VW 19 E Golf, me targa ..., në në fshatin P., duke i shkaktuar kështu të dëmtuarve M.A. dhe S.R. lëndime trupore. Fajtor i aksidentit ka dal të jetë i padituri A.Z., vozitësi i automjetin VW 19 E Golf, gjë e cila është vërtetuar me raportin e policisë me nr. ..., të datës 16.09.2011 dhe ekspertiza e komunikacionit të përpiluar nga eksperti S.B., të datës 18.12.2019, të cilës ekspertizë gjykata ia ka falur besimin e plotë, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, të cilën gjykata e ka vlerësuar si të drejtë për vlerësimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Po ashtu, gjykata ka ardhur në përfundim se i padituri përveç se ka qenë fajtor për shkaktimin e aksidentit në kohën kur është shkaktuar aksidenti i njëjti nuk ka poseduar mbulesë sigurie valide të automjetit me të cilin e ka shkaktuar aksidentin që vërtetohet nga raporti i policisë nr. ..., i datës 16.09.2011, dhe polica e sigurimit TPL e datës 13.01.2012, me të cilën është konstatuar se polica e sigurimit të automjetit me të cilin është shkaktuar aksidenti ka skaduar polica e sigurimit. Ndërsa në anën tjetër pjesëmarrësit tjetër në komunikacion përkatësisht palët e dëmtuara tashmë janë kompensuar në tërësi nga pala paditëse, apo se pala paditëse i kishte kompensuar personat e tretë. Në bazë të ujdisë jashtëgjyqësore me numër të lëndës Nr. 63/12, e datës 13.03.2012 e arritur në mes paditëses dhe përfaqësuesit të dëmtuarit M.A., gjykata vërtetoi se të dëmtuarit i është paguar kompensimi i dëmit jo material në vlerë të përgjithshme prej 432.00 euro dhe shpenzimet e përfaqësuesit në shumën 215.00 euro, gjithsejtë shuma 647.00 euro. Nga transferi –kontoja e paditëses e datës 20.03.2012, gjykata vërtetoi faktin se përfaqësuesit të dëmtuarit i është bërë pagesa e mjeteve në emër të kompensimit në shumën prej 647.00 €, në llogarinë e tij. Ndërsa në bazë të ujdisë jashtëgjyqësore me numër të lëndës Nr. 1798/11, e datës 29.11.2011 e arritur në mes paditëses dhe përfaqësuesit të dëmtuarit S.R. për çështjen e akontacionit, gjykata vërtetoi se me këtë ujdë të dëmtuarit i është paguar akontacioni në vlerë të përgjithshme prej 1,000.00 euro, përmes xhirollogarisë së përfaqësuesit të tij. Nga ujdia jashtëgjyqësore me numër të lëndës Nr. 1798/11, e datës 25.05.2012 e arritur në mes paditëses dhe përfaqësueses të dëmtuarit S.R., gjykata vërtetoi se të dëmtuarit i është paguar kompensimi i dëmit jo material në vlerë të përgjithshme prej 3,000.00 euro. Nga urdhër-transferi BKS nr. 801/12, i dt.30.05.2012, për lëndën nr. BKS –Fondi i Kompensimit nr. 1798/11, i datës 25.05.2012, gjykata vërtetoi se paditësja ka urdhëruar që të dëmtuarit S.R. t'i kompensohet dëmi jo material, në shumën 3000 euro, i pësuar në aksidentin e ndodhur me datë 16.09.2011. Andaj, bazuar në këto fakte, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri duhet të obligohet që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të paguajë shumën prej 4,647.00 €.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 17 par.1, 154 par.1, dhe 242 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 3/3/1978, si dhe nenit 10 dhe 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018). Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449.1, 452 dhe 453.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar, nuk është

i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat pala ankuese ka pretenduar në ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit së aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shqyrtuara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit, vlerëson së nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta vendimin e ka bazuar në provat e administruara, ku në bazë të ekspertizës së komunikacionit të datës 18.12.2019, të përpiluar nga eksperti S.B., është konstatuar se shkaktar i aksidentit të datës 16.09.2011, në të cilin kanë pësuar lëndime trupore të dëmtuarit e kompensuar nga paditësja është ngasësit i automjetit “A”, këtu i padituri, ndërsa ngasësi i automjetit “B” që ishte përfshirë në aksident nuk i ka dhënë kontribut aksidentit. Kurse nuk ishte kontestuese së automjeti të cilin e drejtonte i padituri në momentin e aksidentit nuk kishte regjistrim përkatësisht i kishte skaduar palica e sigurimit. Për me tepër, këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe me raportin e aksidentit ..., të datës 16.09.201, policen e sigurimit (TPL), të datës 13.01.2012. Ndërsa është vërtetuar së paditësja i ka kompensuar palët e dëmtuara në këtë aksident në shumën të cilën ka kërkuar që ta rimbursojë nga i padituri si person përgjegjës për shkaktimin e aksidentit.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që në bazë të nenit e nenit 18 par.1 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Kurse me par.4 të po këtij neni parashihet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Ndërsa në bazë të nenit 154 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD), i cili ligj ka qenë në fuqi në kohen kur është shkaktuar aksidenti, është paraparë së *“Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar, paditësja është përgjegjëse për kompensimin e dëmit personave të dëmtuar nga automjetet pronaret e të cilëve nuk janë të mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive. Në rastin konkret në bazë të ujdisë jashtëgjyqësore me numër të lëndës Nr.

63/12, e datës 13.03.2012, transferit bankar të datës 20.03.2012, është vërtetuar së paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar në aksidentin në fjalë M.A., në shumën prej 647.00 euro. Ndërsa në bazë të ujdisë jashtëgjqësore me numër të lëndës Nr. 1798/11, të datës 29.11.2011, ujdisë jashtëgjqësore me numër të lëndës Nr. 1798/11, të datës 25.05.2012, transferit bankar të datës 23.12.2011, dhe transferit bankar të datës 01.06.2012, është vërtetuar së paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar S.R., gjithsej në shumën prej 4,000.00 euro, andaj e njëjta ka të drejtën e regresit ndaj të paditurit si person përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe atë për shumën e paguar dhe kamatën. Gjykata vlerëson se i padituri ka për detyrë që ta bëjë kompensimin e dëmit të cilin e ka shkaktuar në aksident, pasi që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti nuk ka pasur sigurim. Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura Gjykata e Apelit vlerëson së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Lidhur me pretendimin e të paditurit të paraqitur në ankesë së paditësja me rastin e kompensimit të dëmit palëve të dëmtuara e ka neglizhuar Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, pasi që kompensimin e dëmit e ka bërë pa e ftuar të paditurin që të deklarohet dhe në mungesë të ekspertizave dhe aktgjykimit penal, Gjykata e Apelit, vlerëson së paditësja në këtë rast ka vepruar në përputhje me nenin 18 par.1 të këtij ligji, pasi që e njëjta në bazë të këtij neni ka qenë e obliguar që t'i kompensoj palët e dëmtuara për lëndimet e pësuar në aksident të cilat janë konfirmuar nga raporti i aksidentit, raportet mjekësore dhe nga komisioni vlerësues, duke qenë së automjeti të cilin e drejtonte i padituri nuk kishte policë valide të sigurimit, ndërsa sa i përket përgjegjësisë për shkaktarin e aksidentit kjo është vërtetuar edhe në bazë të ekspertizës së komunikacionit të nxjerrë në këtë procedurë.

Vendimi për kamatën është i drejtë dhe gjënë mbështetje në dispozitat e nenit 277 të LMD-së, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit, dhe po ashtu vendimi për shpenzimet gjyqësore është i drejtë dhe gjen mbështetje në nenin 449, 452 dhe 453 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që lartësia e shpenzimeve të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë i referohet shpenzimeve për taksën gjyqësore për padi dhe shpenzimeve për ekspertizë të komunikacionit.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.446/2021, datë 22.05.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci